# DËSHMI ARKIVI

Factcheck.al · arkiv i pandryshueshëm i mediave shqiptare

**A-440968**
VERSIONI

**Ky dokument nuk është prova.** Prova janë bajtët e ruajtur: HTML-ja e faqes, pamja e saj, dhe zinxhiri i hash-eve që i lidh. Kjo dëshmi është paraqitja e tyre, e prodhuar automatikisht. Verifikohet me kodin më poshtë **pa na pyetur ne**.

## ARTIKULLI

| | |
|---|---|
| TITULLI | Reagimi - Peka: Ramës-SPAK-ut dhe Ron Yeffet, telenovelë doni? Të hënën do të publikojmë pjesë të re të audio-përgjimit |
| ADRESA | `https://www.syri.net/politike/916426/peka-rames-spak-ut-dhe-ron-yeffet-telenovele-doni-te-henen-do-te-publikojme-pjese-te-re-te-audio-pergjimit/` |
| BURIMI | syri.net |
| GJENDJA | edited |

## KOHA

| | |
|---|---|
| KAPUR NGA NE | 13 shtator 2026, 19:16:06 UTC<br>*Dritarja jonë e pasigurisë: ± 300 s — intervali me të cilin e kontrollojmë këtë burim.* |
| DEKLARUAR NGA PORTALI | 13 shtator 2026, 18:59:46 UTC<br>*Koha e deklaruar vjen nga pala që po vlerësohet. Ora jonë nuk preket prej saj, dhe të dyja shfaqen këtu të ndara.* |

## HASH-ET · SHA-256

| | |
|---|---|
| PËRMBAJTJA | `02b0028f26d63ab1433660ddc4d65eee974124b5a8fa42b52af22e6fe930ae9d` |
| TEKSTI | `92066aeab54cd91e1e1c6128706010f0766c26179015e6746ebcb7f8a1eedb7a` |
| PAMJA | `3b9c8d89b76d517f7188c86bc0e7624753f53ef42c5ef37fdc37287692f643bc` |

## ZINXHIRI I PROVËS

| | |
|---|---|
| KJO HYRJE | `636c5c8842d84bb3b5f7ddfd02eb05134f156ed29c37289aa71c7e0f70175ef9` |
| E MËPARSHMJA | `ec3fee05ec746f92554213e09b24494e0e9b679745da9895bcffe5f8add567d5` |
| RRËNJA MERKLE | – |
| ANKORIMI | nuk është ankoruar ende<br>*Kjo hyrje nuk është përfshirë ende në asnjë pemë Merkle të dërguar. Zinxhiri i hash-eve provon rendin dhe integritetin; koha jo.* |

### SKANOJE PËR TA VERIFIKUAR

Kodi të nxjerr te eksploruesi i STAMLES. Ai regjistër nuk është yni: nëse serveri ynë bie nesër, vula mbetet aty ku është.

Faqja tregon njërën nga tri gjendjet — **nuk u gjet**, **në radhë**, ose **e konfirmuar** me bllokun, rrënjën Merkle dhe transaksionin në Polygon. Krahaso hash-in që gjen atje me atë të shtypur më lart: nëse përputhen, kjo kapje ekzistonte para asaj ore, dhe ne nuk mund ta kishim ndryshuar pas saj.

`https://scan.stamles.eu/verify/636c5c8842d84bb3b5f7ddfd02eb05134f156ed29c37289aa71c7e0f70175ef9`

## PAMJA E FAQES

Renderuar nga HTML-ja jonë e ruajtur, jo nga rrjeti. **Riprodhon kopjen tonë, jo pamjen e atëhershme:** stilet dhe imazhet e largëta mund të mos ekzistojnë më ose të kenë ndryshuar.

Motori: chromium-stored+assets · dritarja 1280×1024 px












# Peka: Ramës-SPAK-ut dhe Ron Yeffet, telenovelë doni? Të hënën do të publikojmë pjesë të re të audio-përgjimit

20:59, 13/09/2026

ZMADHO TEKSTIN

+ Aa -

Gazetari Çim Peka ka reaguar në rrjetet sociale, duke paralajmëruar publikimin e një tjetër pjese të audio-përgjimeve që lidhen me Edi Ramën, Ron Yeffet, ministrin e Mbrojtjes, Ermal Nuhu.

Peka shkruan se, debati për çështjen e vilës së Belinda Ballukut po përdoret për të zhvendosur vëmendjen nga audio-përgjimet.

‘Për Ramën-SPAK-Yeffet: Telenovelë doni. Atë do t’ju japim. Të hënën në 20:45, pjesë e re audio-përgjimi’, shkruan Peka.

Peka paralajmëron se pjesa e radhës do të fokusohet te marrëdhëniet mes Ron Yefet dhe ish-zv/kryeministres Belinda Balluku, se si Yefet kishte ndikim në vendimmarrjen e Ministrisë së Energjisë.

View this post on Instagram

## më të lexuarat

SYRI TV/ ‘Kufizimi i takimeve të Metës, shqetësim serioz’ , Komiteti i Helsinkit letër paraburgimit 313

Modeli Kayo, Bozdo: Janë krijuar 20 kompani, kanë marrë monopolin në disa fusha

SYRI TV/ Ngërçi për pagat e gjyqësorit përfundon në dyert e SPAK

Kayo-Qeveria dhe Rama lakuriq, përse SPAK-u fshihet dhe nuk i sheh?

Berisha në Konventën Republikane në Dallas - Takime me drejtues të Departamentit të Drejtsisë, Takime me senatore

Shqiptari nga Anglia: Rama dha urdhër të mos hyjmë në shesh! Të rrimë këtu derisa ta shporrim nga zyra antishqiptarin

A post shared by Cim Peka (@cim99)

**Reagimi i gazetarit Çim Peka:**

Për Ramën-SPAK-Yeffet: Telenovele doni.

Atë do tu japim. Të Hënë në 20:45 pjesë e re audio-përgjimi.

Nuk e spostoni dot vëmendjen nga superskandali me një vilë më shumë apo një vilë më pak të Belindës!

Rama në bashkëqeverisje me SPAK, paska vendosur të mundohet të spostojë të gjithë debatin dhe vëmendjen nga audio-përgjimet e Ron Yefet, Ermal Nuhut dhe në fakt vetë Ramës.

Pasi i plotësoi dëshirën duke dhënë Ministrin e Brendshëm drejtuesit të ri të SPAK, duket se Rama ka marrë zemër dhe me porositë e tij të gjitha mediat po mundohen të spostojnë debatin rreth një vide më shumë apo një vide më pak të Belinda Ballukut.

Por meqënëse SPAK është vendosur në shërbim të Ramës dhe po mundohet të krijojë një Big Brother për të spostuar vëmendjen, pa merak, sepse kësaj radhe jemi shumë hapa para. Nëse duan Big Brother për të tërhequr vëmendjen, atë po ua japim ne.

Nga nesër, sërish vazhdim përgjimesh. Janë tre orë, realisht nuk e dimë se çfarë ka sepse Ameta me këtë punë po merret. I papunë është, ka kohë sa të duash, janë në disa gjuhë dhe duhet të përkthehen, duhet prerë.

Por nesër një tjetër pjesë audio-përgjim, ku do e shikoni se si një monstër si Ron Yefet drejton Ministrinë e Energjitikës të Belinda Ballukut kur ajo ishte zëvendëskryeministre dhe ministre. Ai vendos për gjithçka dhe do e kuptoni vetë se e gjithë loja me një vidë më shumë apo një vidë më pak e Ramës, SPAK dhe Ballukut, është për të spostuar vëmendjen nga super skandali i kontrollit të gjithçkaje nga Ron Yefet dhe Edi Rama.

Mos keni merak, Big Brother doni, Big Brother do e bëjmë. Çdo javë do keni pjesë të reja. Nesër, pjesa e re.

© SYRI.net

Lexo edhe:



‘Rama në burg, Belinda në burg’/ Protestuesit ‘zënë mat’ Ballukun: O hajdute! Te cila vilë do të shkosh?



‘Nesër më shumë!’/ Mbyllet protesta e 106-të, protestuesit: Rama të japë dorëheqjen



Qytetarët në ditën e 45-të të protestës: Divjaka bashki!

SYRI TV/ Rama reagon pas kallëzimit ndaj Ministrisë së Financave, kërcënon gjyqtarët dhe prokurorët

Pengimi i drejtësisë/ Prokuroria në Hagë kërkon 6 vjet burgim për Hashim Thaçin

'Po blejnë influencë te zyrtarët e BE', Xhaferri: Rama i mori 17 miliardë lekë Universitetit të Tiranës për Kolegjin e Evropës

TË NGJASHME

VIDEO/ Dita e 106 e protestës qytetarët marshojnë në Tiranë:

‘Yllka Sheta, e afërme e Linda Ramës’, Spahia: Ministrja s’e mohoi

‘Është java e mosbindjes civile’/ Qytetari: Protestën s’e ndalin dot me

Frika për të mos iu përgjigjur pyetjes kyçe: Kush është Rony Yeffet?

Shqipëria kërkon revolucion

denoncimin, paratë në shëndetësi i kontrollon Rama

forcë dhe presione!

Edi Rama në Michigan, organizatorët kërcënojnë kundërshtarët

Viti i ri shkollor/ Susaj thirrje mësuesve: Mësojuni fëmijëve reagimin e atdhedashurinë, jo heshtjen

VIDEO/ Qytetarja: Belinda, Olsi Rama, Subashi e ca kriminelë më kanë rrëmbyer 300 dynym tokë në Fier



SYRI.net është agjencia më e madhe e lajmeve në Shqipëri, që brenda një kohe të shkurtër është kthyer në lider të informacionit. Në SYRI.net do të gjeni opinionistë më me emër në vendin tonë, investigime dhe lajme që nuk do ti gjeni diku tjetër. Lajmet në SYRI.net janë prodhim i SYRI.net dhe nuk lejohet marrja e tyre pa një komunikim të mëparshëm me redaksinë. Ju ftojmë të klikoni dhe të na shkruani sa herë që ju mendoni se duhet. Stafi i SYRI.net

Për informacione info@syri.net, për reklama marketing@syri.net

Pamja këtu është e ri-koduar për ta futur në dokument. Artefakti autoritar është skedari WebP i ruajtur, dhe hash-i i tij është ai i shtypur te faqja e parë — pra dallimi është i verifikueshëm, jo i fshehur.